



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4211 Prot

Lezhë, më 29 / 0 /2022

VENDIM

Nr. 26, Datë 23 . 03 .2022

“PËR

**MIRATIMIN E LISTAVE TË PËRFITUESVE PËR GRANTE RIKONSTRUKSIONI  
PËR SHTËPITË INDIVIDUALE DHE BANESA NË NDËRTESA (PALLATE) ME  
SHKALLË DËMTIMI DS1, DS2, DS3”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës; të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr. 76, datë 09.06.2020 “Për miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2 dhe DS3, për banesat e demtuara nga termeti i datës 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë”; të VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindertimit; të VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit nga programet e procesit të rindertimit për strehim”; të VKB nr. 80, datë 25.06.2020 “Për miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të

rikonstruksinit”, dhe kontratës tip për të përfituar nga grantet e rikonstruksinit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së përfituesve, (subjekteve që plotësojnë kriteret për përfitim) nga programi i granteve të rindërtimit (granti i rikonstruksionit), sipas Aneksit Nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
ERNEST RAKAJ**

